

VENDIM ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC
NË EMËR TË POPULLIT

24. 11. 2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PENAL, gjyqtari

i vetëm gjykues Hakile Ilazi me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja pyllit nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II.nr.959-1/13 e dt. 18 shtator 2013, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurores së Shtetit Sebahate Sinani, të pandehurit [REDAKTUAR], me datë 12.10.2017, mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me dt.19.10.2017 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] K.Ferizaj, i lindur me dt. [REDAKTUAR] në të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Me dt.25 prill 2013 rreth orës 14:00. Në rajonin Ekonomiko Pyjor të fsh.Neredime – Jezerc, në vendin e quajtur “Sharanik” me qëllim të vjedhje, ka prerë me sharrë motorrike, 12 trungje, ahu të njomë, diametër 29-37 cm, në vëllim prej 10.82 m³, me të cilin veprim ka dëmtuar DBPZHR- Ferizaj, në vlerë prej 1.460,70 €,-

Me të cilën kreu veprën penale vjedhja pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-se

Në bazë të dispozitës së lartshënuar dhe neneve 4,7,17,21, 41, 45, 48 të KPRK-së, si dhe neni 365 të KPPK-se të akuzuarin e,

G J Y K O N

Të akuzuarin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muaj, i cili dënim në mbështetje të nenit 48 par 1 të KPPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet: në punë në dobi të përgjithshme prej 150/një qind e pesëdhjetë/ orëve të cilin do ta kryej në afat prej 6 /gjashtë/ muaj, prej ditës së fillimit të ekzekutimit DHE

Me dënim me gjobë në shumë prej 300 €, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari për 1/NJË/VIT pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë nuk kryen veprën tjetër penale

Konform nenit 48 par 2 të KPRK-së, Shërbimi Sprovues i Kosovës në Ferizaj, cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditën, javën që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme shoqërore si dhe mbikëqyrjen e punës në dobi të përgjithshme shoqërore.

Në mbështetje të nenit 48 par 4 të KPRK-së, nëse personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata do të urdhërojë zbatimin e dënimit të shqiptuar sipas këtij aktgjykimi në përpjesëtim me punën e kryer.

Obligohet i pandehuri që të [REDAKTUAR] - [REDAKTUAR] në emër të kërkesës pasurore juridike t'i kompensojë shumën në vlerë prej 1.460,70 €, - (njëmijë e katër qind e gjashtë dhjetë euro e shtatëdhjetë cent) €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Obligohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzet e pesë/ € në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj - me aktakuzën të evidentuar PP.II.nr.959-1/13 e dt. 18 shtator 2013, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 12.10.2017, në të cilën shqyrtim fillestar gjyqësor prokurorja e shtetit Sebahate Sinani, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtorë dhe t'i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Lidhur me deklarimin për fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar, i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendimin te thellë për veprën penale të kryer, ka premtuar se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre, i gjendjes së dobët ekonomike duke propozuar një dënim sa më të butë.

Prokurorja e shtetit Sebahate Sinani duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë për të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin të shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore si dhe në shqyrtimin gjyqësor: fletëparaqitja e rojës së pyllit si dhe procesverbali mbi vlerësimin e dëmit nr.228/2013.

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë gjyqtarja, vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, sikurse me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në diapozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë që në fillim të shqyrtimit kryesor, pendimin e real dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, i gjendjes së varfër ekonomike, nuk është i njohur më parë si kryes i veprave penale, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se I akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Obligohet i pandehuri që të [REDAKTUAR] në emër të kërkesës pasurore juridike t'i kompensoj shumën në vlerë prej 1.460,70 €, - *(njëmijë e katër qind e gjashtë dhjetë euro e shtatëdhjetë cent)* €, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Obligohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzet e pesë/ € në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DIVIZIONI PENAL,

P.nr.1406/13, me datë 16.10.2017.

Zyrtarja ligjore

Ganimete Avdiu



Gjyqtari

Hakile Ilazi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të aktgjykimi, Gjykatës së Apelit Kosovës . Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.